

RREGULLORE MBI SJELLJEN E PAHIJSHME SEKSUALE

PARANDALIMI DHE MBROJTJA
NGA NGACMIMI, SHFRYTËZIMI
DHE ABUZIMI SEKSUAL

Nëntor 2020

RREGULLORE NDËRKOMBËTARE



PËRDORUESIT KRYESORË

E detyrueshme për:	<ul style="list-style-type: none"> Të gjitha shoqatat anëtare të SOS Children's Villages (Fshatrat e Fëmijëve) International. Të gjitha zyrat e SOS Children's Villages International, duke përfshirë Sekretariatën e Përgjithshëm dhe operacionet e drejtuara nga GSC
--------------------	--

POLITIKAT E NDËRLIDHURA

Politika e SOS:	<p>Premtimi i Kujdesit i SOS</p> <p>Kodi i Sjelljes</p> <p>Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve</p> <p>Politika për Barazimë Gjinore</p>
-----------------	---

PROCESI I ZHVILLIMIT

E miratuar nga:	Senati Ndërkombëtar
Zhvilluar nga:	Një ekip ndërfunksional (Burimet Njerëzore & Zhvillimi i Organizatës, Programi, Gjinia, Përfaqësuesi i CVI) nga shoqatat anëtare (SOS Malawi, SOS Holandë) dhe GSC, në konsultim formal me 15 shoqata anëtare nga të gjitha rajonet dhe me të gjithë zyrat ndërkombëtare rajonale dhe me funksionet përkatëse të IO.
Përgjegjës për përmbajtjen:	Masat për Mbrojtjen e Fëmijës; Burimet Njerëzore dhe Zhvillimi i Organizatës; Integriteti, Pajtueshmëria & Ligjore.
Gjuha origjinale:	<i>Analisht</i>

HISTORIKU I NDRYSHIMEVE

Versioni	Data	Ndryshimet
1.0	5 nëntor 2020	Rregullore e miratuar nga Senati Ndërkombëtar

TABELA E PËRMBAJTJES

1	Hyrje	3
2	Përkufizimet	3
3	Fusha dhe implementimi	4
4	Qasja jonë ndaj PSHEA	6
5	Kërkesat minimale	8
6	Angazhimi ynë	8
7	Parandalimi	10
8	Reportimi	12
9	Reagimi	14
	Shtojca	17
A.	Termet dhe shkurtesat kryesore të përdorura në dokument	17
B.	Lista e kanaleve ndërkombëtare të raportimit	17

1 Hyrje

SOS Fshatrat e Fëmijëve (referuar edhe si "federata") përpiqet të sigurojë një mjedis të sigurt për të gjithë fëmijët, të rinjtë, të rriturit dhe partnerët me të cilët ne punojmë. Përveç kësaj, një mjedis i sigurt është një parakusht që stafi dhe vullnetarët tanë të zhvillojnë dhe përmbushin misionin tonë. Ne synojmë të sigurojmë që pjesëmarrësit, stafi, vullnetarët dhe partnerët e programit të jenë të lirë nga ngacmimet seksuale, shfrytëzimi dhe abuzimi që rrjedhin nga sjellja e pahijshme e stafit ose e çdo personi tjetër që vepron në emër të organizatës. Kjo përpjekje është e bazuar në vlerat e organizatës tonë si llogaridhënia, kuraja, besimi dhe përkushtimi.

Rregullorja e mëposhtme për parandalimin dhe mbrojtjen kundër ngacmimit, shfrytëzimit dhe abuzimit seksual bazohet në Kodin tonë të Sjelljes, Politikën e Mbrojtjes së Fëmijës, Politikën e Barazisë Gjinore dhe pjesë të tjera të qasjes sonë të integritetit. Ajo përcakton fokusin tonë në parandalimin për të krijuar dhe mbajtur një mjedis të sigurt për të gjithë personat e përfshirë në punën e federatës. Rregullorja përshkruan mekanizmin tonë të reagimit ndaj rasteve të dyshimeve për sjellje të pahijshme seksuale ndaj çdo personi, pavarësisht nga mosha, gjinia, seksualiteti, orientimi seksual, paaftësia, feja ose origjina etnike.

Pavarësisht masave tona parandaluese, ne e pranojmë se brenda federatës sonë megjithatë mund të ndodhin raste të ngacmimit, shfrytëzimit dhe abuzimit seksual. Në incidente të tilla, ne përpiqemi të krijojmë një mjedis në të cilin të mbijetuarit dhe dëshmitarët të ndjehen të sigurt për të ngritur akuza duke krijuar mekanizma raportimi lehtësisht të qasshëm. Ne do t'i përgjigjemi menjëherë dhe në mënyrë të përshtatshme çdo incidenti të raportuar. Ne do të ndërmarrim veprime përcjellëse për të gjitha akuzat për ngacmim, shfrytëzim ose abuzim seksual dhe të gjitha këto akuza do të trajtohen me respekt dhe konfidencialitet. Ne përpiqemi të garantojmë sigurinë e të mbijetuarve, dëshmitarëve dhe hetuesve. Autorët e dyshuar do të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe sipas procesit të duhur.

Ne i përmbahemi një politike të zero tolerancës për ngacmimin, shfrytëzimin dhe abuzimin seksual. Zero tolerancë për federatën do të thotë se të gjitha pretendimet që konstatohen të vërteta do të pasohen nga masa të qarta disiplinore, të cilat do të jenë në përpjesëtim me seriozitetin e shkeljes.

Mekanizmat tanë të parandalimit dhe reagimit janë të formësuar nga konteksti në të cilin ne punojmë dhe rreziqet e veçanta me të cilat grupet e cënueshme përballen. Masat shtesë për zbutjen e këtyre rreziqeve do të zhvillohen sipas nevojës, si p.sh. për rreziqe specifike për fëmijët, siç është artikuluar në Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve të SOS Fshatrat e Fëmijëve.

Zbatimi i kësaj rregulloreje detyruese do të mbështetet me burime adekuate njerëzore dhe financiare. Senati Ndërkombëtar i SOS Villages International (SOS Fshatrat e Fëmijëve Ndërkombëtare) nënvizon angazhimin e të gjithë organizatës për parandalimin dhe mbrojtjen kundër ngacmimit, shfrytëzimit dhe abuzimit seksual (PSHEA) dhe u bën thirrje të gjitha pjesëve të federatës që të sigurojnë zbatimin e masave të përshkuara.

2 Përkufizimet

2.1 Sjellja e pahijshme seksuale është çdo formë e sjelljes së padëshiruar seksuale dhe merr forma të ndryshme. Njerëzit e të gjitha identifikimeve gjinore mund të jenë qoftë të mbijetuarit ose autorët. Veçanërisht të rëndësishme në kontekstin tonë janë ngacmimi seksual, shfrytëzimi seksual, shtrëngimi seksual dhe abuzimi seksual siç përkufizohet më poshtë. Në këtë rregullore, ne përdorim terminologjinë e ngacmimit, shfrytëzimit dhe abuzimit seksual (SHEA) si një term gjithëpërfshirës dhe çdo rast i raportuar mund të përfshijë një ose më shumë lloje të sjelljes së pahijshme siç përkufizohet më poshtë.

2.2 Ngacmimi seksual

Ngacmimi seksual është çdo avancim seksual i padëshiruar dhe jo i mirëseardhur, kërkesë për favore seksuale, sjellje verbale ose fizike ose gjest i natyrës seksuale, ose çdo sjellje tjetër e

natyrës seksuale që mund të perceptohet në mënyrë të arsyeshme se shkakton ofendim ose poshtërim ndaj një tjetri. Kjo përfshin gjithashtu sjellje të një natyre seksuale që krijon një mjedis pune frikësues, armiqësor ose fyes. Ndonëse zakonisht përfshin një model sjelljeje, ngacmimi seksual mund të marrë edhe formën e një incidenti të vetëm.

2.3 Shfrytëzimi Seksual

Shfrytëzimi seksual është çdo abuzim faktik ose në tentativë, i një pozite të pushtetit diferencial, ose besimit, për qëllime seksuale, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, përfitimin monetar, social ose politik nga shfrytëzimi seksual i një tjetri.

2.4 Shtrengimi seksual

Shtrengimi seksual nënkupton përdorimin e mjeteve verbale ose fizike (përfshirë administrimin e drogave ose alkoolit me ose pa pëlqim) për të marrë aktivitet seksual pa pëlqimin e dhënë në mënyrë të lirshme. Kjo përfshin kapitjen e një individi me kërkesa të pareshtura ose bindjen përmes presionit psikologjik/emocional. Shtrengimi seksual përfshin “grooming” (krijimin paraprak të marrëdhënies me qëllime manipuluese) seksual, i cili është procesi i krijimit të një marrëdhënieje me një fëmijë ose një të ri gjatë një periudhe kohore me objektivin e abuzimit seksual në një fazë të mëvonshme.

2.5 Abuzimi seksual

Abuzimi seksual është ndërhyrja faktike pa leje ose kërcënuese e një natyre seksuale, qoftë me forcë ose në kushte të pabarabarta ose shtrënguese. Abuzimi seksual mund të jetë me kontakt ose pa kontakt.

Abuzimi seksual pa kontakt përfshin (por nuk kufizohet në):

- Bërja e fotografive të zonave gjenitale pa pëlqim (“upskirting”) (fotografimi poshtë fustanit)
- Shpërndarja pa pëlqim e fotove ose videove të personave të zhveshur (“pornografia e hakmarrjes”)
- Detyrimi ose shtrengimi i një tjetri për të parë pornografi
- Diskutimet për seksin ose seksualitetin, që shkaktojnë siklet tek personi tjetër
- Ekspozimi i organeve gjenitale ndaj personit tjetër

Abuzimi seksual me kontakt përfshin:

- Kontakti seksual i padëshiruar fizik jopenetrues – p.sh. kryrësi prek organet gjenitale të të mbijetuarit (es)
- Kontakt seksual fizik i detyruar jopenetrues – p.sh. detyrimi për të prekur organet gjenitale të kryrësit
- Detyrimi ose shtrengimi i një tjetri për të bërë pornografi
- Përdhunimi – p.sh. futja e pjesëve të trupit ose sendeve në vagjinë ose anus të një personi tjetër pa pëlqim ose kur pëlqimi është marrë me detyrim.

3 Fusha dhe implementimi

3.1 Kjo rregullore zbatohet për të gjithë:

3.1.1 Stafin dhe personat që punojnë në emër të ose në **SOS Children’s Villages International**, duke përfshirë Sekretariatit e saj të Përgjithshëm (Zyrën Ndërkombëtare, Zyrat Ndërkombëtare Rajonale, zyrat e tyre të degëve) dhe subjektet që menaxhohen dhe kontrollohen ligjërisht nga SOS Fshatrat e Fëmijëve *International* (i njohur gjithashtu si “operacionet e drejtuara nga Sekretariati i Përgjithshëm (GSC)”), duke përfshirë të gjithë stafin, praktikantët, vullnetarët dhe partnerët (donatorët, partnerët e ofrimit të programit dhe mbledhjes së fondeve, kontraktorët, etj. – shih Shtojcën A)

3.1.2 Stafin dhe personat që punojnë në emër të ose në **shoqatat anëtare** dhe subjektet e lidhura të SOS Fshatrat e Fëmijëve *International*, duke përfshirë të gjithë stafin e tyre, praktikantët, vullnetarët dhe partnerët (donatorët, partnerët e ofrimit të programit dhe mbledhjes së fondeve, kontraktorët, etj. – shih Shtojcën A)

3.1.3 Anëtarët e **organeve ligjore ose drejtuese** të SOS Fshatrat e Fëmijëve *International* dhe të shoqatave anëtare (p.sh. Senati Ndërkombëtar, bordi mbikëqyrës i shoqatës), pavarësisht nëse janë të punësuar apo jo nga SOS Fshatrat e Fëmijëve *International* ose nga shoqata anëtare ose subjekte të lidhura.

3.1.4 Anëtarët e nderit të SOS Fshatrat e Fëmijëve *International*

3.2 Rregullorja përcakton veprimin tonë për parandalimin dhe mbrojtjen nga ngacmimi, shfrytëzimi dhe abuzimi seksual ndaj:

- Pjesëmarrësve të programit (fëmijët, të rinjtë, familjet dhe të rriturit me të cilët punojmë),
- Anëtarëve të komuniteteve me të cilat punojmë, dhe
- Çdo personi që punon në ose në emër të ndonjë prej subjekteve të listuara në seksionin 3.1 më sipër

3.3 Kjo rregullore përcakton kërkesat minimale që duhen zbatuar nga subjektet e përcaktuara në seksionin 3.1 më sipër për:

- Krijimin e një mjedisi të sigurt dhe ndihmën në parandalimin e ngacmimit, shfrytëzimit dhe abuzimit seksual,
- Aktivizimin e kanaleve të raportimit për paraqitjen e shqetësimeve ose pretendimeve të lidhura, dhe
- Reagimin përkatës kur bëhen akuza.

3.4 Të gjitha subjektet e përcaktuara në seksionin 3.1 më sipër do të zbatojnë rregulloren për PSHEA, sipas ligjeve kombëtare në fuqi. Ato duhet të sigurojnë që kërkesat minimale të deklaruara (shih seksionin 5 të këtij dokumenti) janë vendosur. Veprimi i PSHEA i SOS Fshatrat e Fëmijëve International bazohet në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (UNCRC), Konventën e ILO-s për Dhunën dhe Ngacmimin (Nr. 190) 2019, Deklaratën e OKB-së për Dhënien Fund Dhunës kundër Grave, Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe korniza të tjera të të drejtave të njeriut. Aty ku ligjet kombëtare nuk plotësojnë të drejtat themelore të njeriut dhe kërkesat minimale të deklaruara, shoqatat anëtare duhet të përshtatin masat e tyre parandaluese dhe reaguese për të siguruar që të mos ketë shkelje të të drejtave.

3.5 Kjo rregullore bën thirrje për krijimin e një Ekipi të Integritetit dhe Masave Mbrojtëse në çdo shoqatë anëtare, në çdo Zyrë Ndërkombëtare Rajonale (IOR), në Zyrën Ndërkombëtare dhe çdo operacion të drejtuar nga GSC. Ky ekip ndërfunksional mbështet dhe drejton zbatimin e masave parandaluese (seksioni 7 i këtij dokumenti) dhe menaxhon procesin e përgjithshëm të raportimit dhe reagimit duke rekomanduar masa disiplinore adekuate (seksionet 8 dhe 9 të këtij dokumenti). Ekipi përfshin përfaqësues nga Masat Mbrojtëse të Fëmijëve, Pajtueshmëria / Luftimi i Korrupsionit dhe Burimet Njerëzore.

Anëtarët e Ekipit të Integritetit dhe Masave Mbrojtëse emërohen nga:

- drejtori kombëtar/ menaxhues (në shoqatat anëtare).
- drejtori përkatës ndërkombëtar rajonal në çdo IOR.
- Ekipi Menaxhues në Zyrën Ndërkombëtare.

Në varësi të nevojës, shoqatat anëtare mund të krijojnë ekipe të integritetit dhe masave mbrojtëse në nivel programi.

3.6 Implementimi i kësaj rregulloreje do të përfshijë shpërndarjen transparente të përmbajtjes së saj në nivel lokal në gjuhët përkatëse dhe faqet e internetit të organizatës. SOS Fshatrat e Fëmijëve International do të mbështesë zbatimin në shoqatat anëtare aty ku është e nevojshme.

4 Qasja jonë ndaj PSHEA

ANGAZHIMI YNË

Një mjedis i sigurt për stafin tonë dhe për fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit me të cilët punojmë, ku të drejtat e njeriut respektohen dhe përkrahen, dhe ku kultivohen marrëdhënie të shëndetshme. Ne ndërtojmë sisteme organizative, kapacitete dhe ndërgjegjësim për parandalimin dhe mbrojtjen kundër ngacmimit, shfrytëzimit dhe abuzimit seksual. Ne ndërmarrim veprime përcjellëse për të gjitha pretendimet.

QASJA JONË E PARANDALIMIT

Ne kultivojmë një kulturë të përgjegjshmërisë, guximit dhe sinqeritetit, ku ngritja e zërit inkurajohet!

*Ne sigurojmë cikël jetësor më të sigurt
rekrutimi dhe punonjësish.*

*Ne sigurojmë programim më të
sigurt. Partnerët tanë janë të*

PROCEDURA E RAPORTIMIT DHE PËRGJIGJES



5 Kërkesat minimale

Kërkesat minimale të mëposhtme në lidhje me parandalimin dhe mbrojtjen kundër ngacmimit, shfrytëzimit dhe abuzimit seksual do të vendosen në SOS Fshatrat e Fëmijëve International dhe në të gjitha shoqatat anëtare të saj.

-
- 5.1** Emërohet një 'ekip i integritetit dhe masave mbrojtëse' për të udhëhequr masat parandaluese dhe për të menaxhuar procesin e raportimit dhe reagimit duke rekomanduar veprime adekuate (shih 3.5).
-
- 5.2** Të gjitha proceset e rekrutimit përfshijnë kontrolle të dosjes penale, për aq sa është e mundur ligjërisht, ose vetëshpalosje të ndonjë dënimi në lidhje me abuzimin në çfarëdo forme (shih 7.3.4).
-
- 5.3** I gjithë stafi ndjek trajnimin për PSHEA (shih 7.3.7).
-
- 5.4** Veprimet ndërgjegjësuese për pjesëmarrësit dhe partnerët e programit përçojnë pozicionin, politikat dhe mekanizmat e raportimit të PSHEA të SOS Fshatrave të Fëmijëve (shih 7.3.7)
-
- 5.5** Gjatë hartimit të programeve ndërmerren vlerësime të plota të rrezikut të SHEA (shih 7.4).
-
- 5.6** Marrëveshjet me partnerët i referohen në mënyrë specifike kësaj rregulloreje si një dokument i zbatueshëm (shih 7.5.2).
-
- 5.7** Të paktën një email adresë raportimi dhe një kuti raportimi në secilin program dhe çdo zyrë janë funksionale (shih 8.1).
-
- 5.8** Çdo raport (d.m.th. çdo ankesë ose pretendim) i pranuar dokumentohet nga Ekipi i Integritetit dhe Masave Mbrojtëse në një regjistër konfidencial dhe konfirmohet brenda një maksimumi 2 ditësh pune (shih 8.2).
-
- 5.9** Ekipi i integritetit dhe masave mbrojtëse kryen një vlerësim fillestar të pretendimit brenda një maksimumi prej 5 ditësh pune pas marrjes së raportit dhe vendos për hapat e ardhshëm sipas procesit të përcaktuar (shih 9.1).
-
- 5.10** Hetimet kryhen në mënyrë të paanshme nga hetues të trajnuar të brendshëm ose të jashtëm. Hetimet porositen, planifikohen, dokumentohen dhe kryhen sipas parimeve të sigurisë, konfidencialitetit, ligjshmërisë dhe përpikmërisë (shih 9.2).
-
- 5.11** Vendimi për pasojat dhe veprimet përcjellëse merret nga niveli më i lartë i menaxhimit në subjektin në fjalë brenda maksimum 20 ditë pune pas marrjes së raportit të hetimit (shih 9.3).
-

6 Angazhimi ynë

6.1 Federata është e përkushtuar të ofrojë një mjedis të sigurt për stafin dhe fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit me të cilët punojmë, ku të drejtat e njeriut respektohen dhe mbështeten, si dhe kultivohen marrëdhënie të shëndetshme. Ne jemi më tej të përkushtuar për të ofruar një mjedis ku ka ndërgjegjësim dhe përgjigje adekuate ndaj ngacmimit, shfrytëzimit dhe abuzimit seksual. Ne punojmë me komunitetet, autoritetet dhe organizatat e tjera për të promovuar një mjedis të sigurt pa SHEA. Ne angazhohemi për një proces të nxjerrjes së mësimave nga të gjitha incidentet e raportuara dhe reagimi ndaj tyre. Mësimet e nxjerra do të inkorporohen në çdo raport hetimor.

6.2 Federata punon në mbi 130 vende dhe territore anembanë botës në kontekste shumë të larmishme. Veprimet tona parandaluese dhe mbrojtëse i kushtojnë vëmendje të veçantë situatës specifike lokale dhe rreziqeve që lidhen me grupet e cënueshme (veçanërisht fëmijët, të rinjtë, gratë dhe personat me aftësi të kufizuara).

Në veçanti, ne:

- 6.2.1** Presim respektim të Kodit të Sjelljes nga stafi dhe të gjithë ata që përfshihen nën 3.1. Menaxherët dhe stafi në të gjitha nivelet duhet të krijojnë një mjedis pa ngacmim, shfrytëzim dhe abuzim seksual:
- në vendin e punës,
 - në ndërveprimin me pjesëmarrësit në program, dhe
 - në komunitet.
- 6.2.2** Deklarojmë se ngacmimi, shfrytëzimi, shtrëngimi ose abuzimi seksual i fëmijëve, të rinjve ose të rriturve përbëjnë akte sjelljeje të pahijshme dhe përbëjnë bazë për masa disiplinore deri në dhe përfshirë pezullimin, shkarkimin nga puna dhe procedimet penale.
- 6.2.3** Ndalojmë çdo aktivitet seksual nga stafi (dhe të gjithë ata të përfshirë nën 3.1) me fëmijët nën moshën 18 vjeç, pavarësisht nga mosha e pëlqimit në nivel lokal. Mungesa e njohurisë për moshën e fëmijës nuk është një justifikim. Të gjitha vendimet në përgjigje të pretendimeve të SHEA që përfshijnë fëmijët udhëhiqen nga parimet e UNCRC për interesat më të mira të fëmijës dhe nga Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve e SOS Fshatrat e Fëmijëve dhe udhëzuesit për përdoruesin të Raportimit dhe Përgjigjes.
- 6.2.4** Ndalojmë çdo marrëdhënie intime ose seksuale midis anëtarëve të stafit (dhe të gjithë atyre që përfshihen nën 3.1) dhe pjesëmarrësve të rritur të programit të moshës mbi 18 vjeç për të cilët ata kanë ndonjë përgjegjësi, ose përfshirje (sado të largët), në zhvillimin e atij personi dhe/ose mirëqenien personale.
- 6.2.5** Pranojmë se marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit rrisin rrezikun e SHEA në vendin e punës. Marrëdhëniet intime midis mbikëqyrësve dhe punonjësve dekurajohen dhe rekomandohet fuqimisht që ato t'i shpalosen mbikëqyrësit përkatës dhe BNj. Duhet të ndërmerren veprimet e duhura për të ndryshuar linjën e raportimit dhe për të shmangur një marrëdhënie të ngushtë pune, duke siguruar njëkohësisht që asnjëra palë të mos ketë trajtim diskriminues.
- 6.2.6** Ndalojmë shkëmbimin nga stafi i SOS Fshatrave të Fëmijëve (dhe të gjithë ata që përfshihen nën 3.1) të parave, dhuratave, punësimit, mallrave, shërbimeve ose shpërblimeve të tjera jomonetare në këmbim të seksit, favoreve seksuale ose formave të tjera të sjelljes poshtëruese dhe degraduese shfrytëzuese të pjesëmarrësve të programit ose anëtarëve të stafit (dhe të gjithë ata të përfshirë nën 3.1).
- 6.2.7** Pranojmë se puna seksuale merr forma të shumta dhe në shumë vende është e ligjshme. Megjithatë, federata punon me fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit të cilët janë veçanërisht të cenueshëm ndaj çdo efekti negativ të punës seksuale dhe janë në rrezik më të madh trafikimi dhe shfrytëzimi. Kjo është veçanërisht e vërtetë në vendet ku puna seksuale është e paligjshme. Duke pasur parasysh këtë, federata dekurajon fuqimisht stafin (dhe të gjithë ata që përfshihen nën 3.1) nga prokurimi i shërbimeve nga punonjëset e seksit, veçanërisht kur është e paligjshme sipas ligjit.
- 6.2.8** Pohojmë përgjegjësinë e stafit (dhe të gjithë atyre që përfshihen nën 3.1) dhe pjesëmarrësve të programit për të raportuar menjëherë incidentet ose shqetësimet e ngacmimit, shfrytëzimit ose abuzimit seksual për të cilat ata marrin dijeni. Raportimet duhet të bëhen edhe nëse identiteti i autorit nuk dihet. Raportet e dorëzuara në mirëbesim nuk do të kenë asnjë pasojë negative për raportuesin, edhe nëse pretendimi më vonë rezulton i rremë. Prezumimi i pafajësisë ekziston gjatë gjithë procesit të hetimit. Pretendimet keqdashëse do t'i nënshtrohen masave disiplinore. Nëse pretendimet ose dyshimet nuk konfirmohen përmes një procesi hetimor të pavarur, *organizata bën çdo përpjekje për të siguruar rehabilitimin e subjektit të hetimit.*

7 Parandalimi

Krijimi i sistemeve organizative, kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit për parandalimin dhe mbrojtjen kundër ngacmimit, shfrytëzimit dhe abuzimit seksual do t'u mundësojë SOS Fshatrave të Fëmijëve të vendosin bazat për parandalimin e SHEA në të gjithë federatën. Çdo shoqatë anëtare dhe SOS Fshatrat e Fëmijëve International vendosin masat e mëposhtme parandaluese.

7.1 Forcimi i kulturës organizative

7.1.1 Llogaridhënia: Duke u mbështetur në vlerën tonë thelbësore të llogaridhënies, SOS Fshatrat e Fëmijëve International dhe shoqatat anëtare të saj do të punojnë në këto tre fusha për të siguruar llogaridhënie nga lartë dhe poshtë:

- *Llogaridhënia individuale:* I gjithë personeli (dhe të gjithë ata që përfshihen nën 3.1) duhet të respektojnë këtë rregullore dhe Kodin e Sjelljes të SOS Fshatrat e Fëmijëve. Ata pritët të promovojnë dhe mbështesin një kulturë respekti, dinjiteti, besimi dhe llogaridhënieje që pengon shkeljet.
- *Llogaridhënia e lidershit:* Menaxhmenti është përgjegjës për krijimin e një mjedisi të hapur dhe udhëheqjen e organizatës në parandalimin dhe reagimin ndaj SHEA në të gjitha kontekstet. Kjo përfshin burimet adekuate për veprimet parandaluese dhe mekanizmat e raportimit dhe reagimit.
- *Llogaridhënia organizative:* SOS Fshatrat e Fëmijëve International dhe çdo shoqatë anëtare është përgjegjëse për të ndërmarrë veprime për të gjitha raportet e SHEA. Duhet të ekzistojë një sistem efikas raportimi dhe reagimi, i cili është i përqendruar te të mbijetuarit, i paanshëm dhe ruan konfidencialitetin.

7.1.2 Kuraja: SOS Fshatrat e Fëmijëve International dhe shoqatat anëtare të saj do të vazhdojnë të ndërtojnë një kulturë të fortë organizative të kurajës dhe të sinqeritetit, ku njerëzit të kenë mundësinë të ngrenë zërin kundër padrejtësisë. Kur diçka nuk arrin të përmbushë standardet tona, organizata do të mësojë prej saj dhe do ta përdorë atë si një katalizator për ndryshim. Kjo do të bëhet duke punuar në mënyrë aktive për të zhvilluar organizatën dhe për të inkurajuar një kulturë ku njerëzit mund të flasin hapur për tema të vështira, sfiduese dhe shpesh tabu, dhe duke trajtuar shkaqet themelore dhe faktorët e rrezikut për SHEA.

7.1.3 Besimi: SOS Fshatrat e Fëmijëve International dhe shoqatat e saj anëtare do të punojnë për të ruajtur një kulturë brenda organizatave të tyre përkatëse, ku ata që raportojnë incidente të SHEA mund të besojnë se organizata do t'i marrë ata seriozisht dhe do t'i trajtojë me respekt dhe dinjitet. Të gjitha shkeljet e raportuara do të trajtohen në mënyrë konfidenciale, duke vënë në plan të parë sigurinë e të gjitha palëve. Për të gjitha raportet do të ndërmerren veprime përcjellëse sipas proceseve të përshkruara në udhëzuesit përkatës të përdoruesit, dhe palët përkatëse do të marrin përditësime të rregullta mbi progresin dhe rezultatin e atij procesi.

7.1.4 Angazhimi: Vizioni i federatës është që “çdo fëmijë i përket një familjeje dhe rritet me dashuri, respekt dhe siguri”. Prandaj, federata i bën thirrje të gjithë stafit (dhe të gjithë atyre të përfshirë nën 3.1) në SOS Fshatrat e Fëmijëve International dhe në secilën prej shoqatave anëtare të saj dhe të gjithë pjesëmarrësve të programit që të angazhohen ndaj vlerave tona organizative dhe të punojnë për të parandaluar ngacmimin, shfrytëzimin dhe abuzimin seksual (SHEA) në ndjekje të këtij vizioni.

7.2 Promovimi i Barazisë, Paanësisë dhe Drejtësisë

Në punën tonë për parandalimin e SHEA, ne punojmë drejt trajtimit të barabartë sipas një procesi të rregullt, duke pranuar se disa faktorë e bëjnë veprimin e barabartë të domosdoshëm dhe ne kërkojmë drejtësi për të gjithë, pavarësisht nga pabarazia reale ose e perceptuar.

7.2.1 Barazia gjinore

SOS Fshatrat e Fëmijëve International dhe shoqatat anëtare të saj riafirmojnë angazhimin e tyre për të promovuar barazinë gjinore përmes zbatimit të vazhdueshëm të Politikës për Barazi Gjinore. Ne synojmë të integrojmë barazinë gjinore në të gjitha pjesët e organizatës sonë për të nxitur ndërgjegjësimin ndaj disbalanceve gjinore dhe për të forcuar kapacitetet në të gjithë organizatën për të promovuar barazinë dhe barabarësinë

gjinore.

Ne e pranojmë se gratë dhe vajzat janë të prekura në mënyrë disproporcionale nga SHEA dhe se kjo është rritur nga përfaqësimi i disbalancuar gjinor dhe marrëdhëniet e pushtetit në të gjitha nivelet e organizatës sonë. Ne jemi të përkushtuar për të reduktuar këtë pabarazi për të kontribuar në praktika më të sigurta të punës.

7.2.2 Orientimi seksual ose identiteti gjinor

SOS Fshatrat e Fëmijëve International dhe shoqatat anëtare të saj ripohojnë përkushtimin e tyre për të promovuar një mjedis që është i lirë nga diskriminimi bazuar në orientimin seksual ose identitetin gjinor. Ne përpiqemi të përhapim ndërgjegjësimin se si orientimi seksual ose identiteti gjinor mund ta bëjnë më të vështirë raportimin e shkeljeve të SHEA. Ne do të punojmë për të siguruar që orientimi seksual dhe identiteti gjinor të mos kenë asnjë ndikim në mënyrën se si raportet e shkeljeve të SHEA trajtohen dhe u jepet përgjigje, duke trajnuar në mënyrë të përshtatshme Ekipet e Integritetit dhe Masave Mbrojtëse dhe Hetuesit.

7.2.3 Aftësia e kufizuar

SOS Fshatrat e Fëmijëve International dhe shoqatat anëtare të saj ripohojnë përkushtimin e tyre për të promovuar një mjedis që është i lirë nga diskriminimi i bazuar në aftësi të kufizuara. Ne përpiqemi të përhapim ndërgjegjësimin se si aftësitë e kufizuara rrisin ndjeshëm rrezikun e SHEA dhe se si raportimi i incidenteve të SHEA nga personat me aftësi të kufizuara mund të jetë më i vështirë. Ne do të punojmë për të siguruar që ekipet e integritetit dhe masave mbrojtëse dhe hetuesit të trajnohen siç duhet.

7.2.4 Përkatësia etnike

SOS Fshatrat e Fëmijëve International dhe shoqatat anëtare të saj riafirmojnë përkushtimin e tyre për të promovuar një mjedis që është i lirë nga diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike. Ne do të punojmë për të siguruar që përkatësia etnike nuk ka asnjë ndikim në mënyrën se si raportet për shkeljet e SHEA trajtohen dhe u jepet përgjigje, duke trajnuar në mënyrë të përshtatshme Ekipet e Integritetit dhe Masave Mbrojtëse dhe Hetuesit.

7.3 Cikël jetësor më i sigurt rekrutimi dhe punonjësish

7.3.1 Duhet të bëhet çdo përpjekje për të reduktuar rrezikun e shfaqjes së SHEA në vendin e punës. Kjo është një qasje holistike që përfshin hartimin e programit, mjedisin fizik, praktikat e bashkëpunimit dhe kulturën e vendit të punës.

Proceset e burimeve njerëzore (veçanërisht planifikimi & dizajni i punës, rekrutimi, integrimi, mësimi & zhvillimi, menaxhimi i performancës) do të synojnë reduktimin e këtij rreziku. Mësimi i vazhdueshëm do të ndihmojë në identifikimin e masave efektive për të reduktuar më tej rrezikun.

7.3.2 Në përputhje me shembujt e praktikave të mira, do të vendosen procese të rrepta rekrutimi për të reduktuar mundësinë e punësimit ose angazhimit tjetër të dikujt që mund të përbëjë një rrezik të SHEA për komunitetet me të cilat punojmë dhe për stafin (dhe të gjithë ata që përfshihen nën 3.1) brenda organizatës.

7.3.3 Shpalljet e punës dhe përshkrimet e punës do të detajojnë vlerat organizative dhe angazhimin ndaj PSHEA. Të gjitha proceset e rekrutimit do të vlerësojnë të kuptuarit e aplikantit për PSHEA dhe aftësinë e tyre për të reflektuar mbi vlerat e SOS Fshatrave të Fëmijëve.

7.3.4 Kontrollat e dosjes penale do të jenë, për aq sa është e mundur ligjërish, të detyrueshme për të gjitha rolet. Në situatat kur kontrolli i dosjes penale nuk është i mundur, do të kërkohet vetëshpalosja e çdo dënimi (në lidhje me abuzimin në çfarëdo forme). Kjo vlen edhe për personelin që ndryshon rolet brenda dhe për ata që ka të ngjarë të dërgohen në punë në një kontekst tjetër, në të cilin rast një kontroll duhet të kryhet paraprakisht.

7.3.5 Ofertat e punës do të kushtëzohen me referenca të kënaqshme nga ish-punëdhënësit.

7.3.6 Kjo rregullore dhe politikat përkatëse do të jenë pjesë e integritetit (onboarding) të ofruar për të gjithë stafin e saporekrutuar (dhe të gjithë ata të përfshirë nën 3.1).

7.3.7 Trajnimi dhe rritja e ndërgjegjësimit me stafin (dhe të gjithë ata që përfshihen nën 3.1) është çelësi për ndërtimin e një organizate të bazuar në besim dhe llogaridhënie. Duhet të sigurohet trajnim i detyrueshëm (përfshirë trajnimin e rregullt rifreskues) për stafin në lidhje me të drejtën e tyre për një vend pune pa SHEA dhe fushëveprimin dhe përdorimin e rregullores. Mbikëqyrësit do të trajnohen mbi procedurat e raportimit dhe reagimit. Në varësi

të natyrës së rolit, duhet të ofrohen induksione më të gjera mbi rregulloren e PSHEA dhe rreziqet dhe sfidat specifike të vendit.

7.3.8 Rritja e ndërgjegjësimit me pjesëmarrësit dhe partnerët e programit do të na mundësojë të komunikojmë ndikimin e SHEA, të drejtën për të qenë të lirë nga SHEA, dhe rolet e individëve dhe organizatave në parandalimin, raportimin dhe reagimin ndaj SHEA. Veprimet ndërgjegjësuese përçojnë pozicionin, politikat dhe mekanizmat tona të raportimit të PSHEA.

7.3.9 Proceset dhe vlerësimet e menaxhimit të performancës do të përfshijnë një vlerësim se si individi i ruan vlerat e federatës dhe se si PSHEA ndërthuret me punën e tyre. Proceset e daljes (largimit) do të pyesin në mënyrë eksplicite por të ndjeshme stafin dhe vullnetarët që largohen nëse kanë ndonjë shqetësim të SHEA.

7.4 Programimi më i sigurt dhe zbutja e rrezikut

7.4.1 Në përpjekjet tona të vazhdueshme për të ofruar një mjedis të sigurt për të gjithë fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit me të cilët ne punojmë, masat për ta adresuar këtë do të rrenjosen si një pjesë themelore e të gjithë hartimit të programit, duke përfshirë projektet afatshkurtra dhe/ose të njehershme, të cilat kërkojnë pjesëmarrjen e fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve.

7.4.2 Ne i kushtojmë vëmendje të veçantë profileve të rrezikut të grupeve të cenushme, si gratë dhe vajzat, njerëzit që identifikohen me një sërë identitetesh të mundshme gjinore dhe orientime seksuale dhe ata me aftësi të kufizuara dhe grupet etnike minoritare. Ne e pranojmë se rreziqet për këto grupe mund të rriten më tej kur sistemet ligjore nuk njohin ose mbështesin të drejtat e këtyre grupeve. Aty ku ndodh kështu, SOS Fshatrat e Fëmijëve do të ketë kujdes të shtuar për t'i konsideruar ato rreziqe dhe si të zbuten ato.

7.4.3 Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet programeve ku rreziqet mund të rriten, p.sh. projektet humanitare afatshkurtra dhe ndërhyrjet e kujdesit alternativ. Një vlerësim i plotë i rrezikut do të kryhet për të identifikuar komunitetet në rrezik të shtuar të SHEA. Në këto raste, strategjitë e synuara dhe masat rigorozë mbrojtëse duhet të vendosen, sipas kontekstit, p.sh. trajnime, kontrolle të masave mbrojtëse, monitorim dhe rishikime të rregullta.

7.5 Puna me partnerë

7.5.1 Ne synojmë të angazhojmë partnerë si aleatë për parandalimin dhe reagimin ndaj SHEA.

7.5.2 Marrëveshjet me partnerët do t'i referohen në mënyrë specifike kësaj rregulloreje si një dokument i zbatueshëm dhe gjithashtu do të përmbajnë një angazhim nga partneri ndaj procedurave të qarta të raportimit dhe reagimit dhe veprimeve për zbutjen e rrezikut.

7.5.3 Shqetësimet në lidhje me partnerët duhet të raportohen menjëherë nëpërmjet mekanizmave raportues të detajuar më poshtë.

8 Reportimi

Gjithsecili mund të ngrejë një shqetësim ose të bëjë një raport te SOS Fshatrat e Fëmijëve për diçka që ka përjetuar ose dëshmuar në lidhje me ngacmimin, shfrytëzimin ose abuzimin seksual. Ne do ta marrim seriozisht çdo raport dhe do të marrim masa në përputhje me rrethanat. SOS Fshatrat e Fëmijëve International dhe çdo shoqatë anëtare do të përcaktojnë dhe zbatojnë procedura të qarta raportimi dhe reagimi sipas kërkesave të mëposhtme.

8.1 Kanalet e raportimit

Kanale të shumfishta të raportimit do të jenë të disponueshme dhe të qasshme për stafin (dhe të gjithë ata të përfshirë nën 3.1), pjesëmarrësit e programit dhe anëtarët e komunitetit. Nëpërmjet këtyre kanaleve, shqetësimet për ngacmimin, shfrytëzimin dhe abuzimin seksual mund të raportohen në mënyrë të sigurt, konfidenciale dhe anonime nëse është e nevojshme. Kjo përfshin kanalet e brendshme dhe të jashtme të si linjat telefonike të ndihmës, numrat e telefonit të autoriteteve, adresat e emailit, etj.

Si kusht minimal, SOS Fshatrat e Fëmijëve International dhe çdo shoqatë anëtare duhet të ketë të paktën

- një adresë emaili të raportimit dhe
- një kuti raportimi në çdo program dhe në çdo zyrë.

Aty ku është e përshtatshme, ngritja e një shqetësimi përmes mbikëqyrësit është sigurisht një opsion. Në përputhje me praktikën e mira, "personat e besueshëm" të brendshëm ose të jashtëm mund të

Parandalimi dhe Mbrojtja nga Ngacmimi, Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual

identifikohen si pika fillestare të kontaktit. Personi i besueshëm ofron mbështetje konfidenciale të linjës së parë për këdo që ka përjetuar ose ka qenë dëshmitar i një incidenti të SHEA, duke ndihmuar raportuesin të vendosë për veprimet e duhura (raportimi formal i incidentit ose kërkimi i këshillave ose mbështetjes së mëtejshme). Personat e besueshëm mund të mbështesin të mbijetuarit dhe autorët e supozuar gjatë çdo hetimi dhe procesi vendimmarrjeje të mëvonshme.

Të gjithë pjesëmarrësit e programit, anëtarët e komunitetit dhe personat e përshkruar nën 3.1 do të kenë informacion se si të qasen në këto kanale të sigurta raportimi. Kjo përfshin postimin e procedurave të raportimit në gjuhët lokale dhe shpjegimin e rregullt të këtyre kanaleve.

8.2 Menaxhimi i rastit

Çdo raport i marrë do të konfirmohet zyrtarisht nga një anëtar i Ekipit të Integritetit dhe Masave Mbrojtëse brenda një maksimumi prej 2 ditësh pune.

Ekipi i Integritetit dhe Masave Mbrojtëse dokumenton të gjitha pretendimet e SHEA dhe ndjekjen e mëvonshme në një regjistër të sigurt dhe konfidencial për të siguruar llogaridhënie.

Të dhënat në regjistër përdoren për të gjeneruar raporte (shih seksionin mbi Raportimin Organizativ).

8.3 Siguria, mbështetja dhe mbrojtja e të mbijetuarve, raportuesve, dëshmitarëve dhe autorëve të dyshuar

Pas marrjes së një raporti, përcaktohen shqetësimet e sigurisë ose nevojat për mbështetje të të mbijetuarit dhe/ose raportuesit dhe ndërmerren veprime të menjëhershme përkatëse (p.sh. ndarja e vendeve të punës).

Shoqata përkatëse anëtare ose SOS Fshatrat e Fëmijëve International do të marrë masa ndaj kujtdo, qoftë ai objekt i raportit (kallëzimit) apo jo, që kërkon apo kryen veprime hakmarrëse ndaj raportuesve, të mbijetuarve apo dëshmitarëve të tjerë.

Të drejtat e autorëve të dyshuar mbrohen duke ndjekur një proces të rregullt, duke përfshirë mbështetjen e kërkuar, prezumimin e pafajësisë dhe sigurimin e konfidencialitetit.

8.4 Konfidencialiteti

Konfidencialiteti duhet të ruhet gjatë gjithë procesit të raportimit dhe reagimit. Informacioni që identifikon individët e përfshirë në një raport do të kufizohet në personelin thelbësor mbi bazën e 'nevojës për të ditur' dhe nuk do të ndahet më tej pa marrë pëlqimin e informuar të atyre që janë të përfshirë, përveç nëse jeta e dikujt është në rrezik, një fëmijë është në rrezik, ose siç kërkohet me ligj.

Raportet mund të bëhen në mënyrë anonime dhe për to ndërmerren veprimet përcjellëse sipas të njëjtit proces raportimi dhe reagimi. Ne inkurajojmë raportuesit të japin emrin e tyre në mënyrë që të lehtësojnë rishikimin dhe ndjekjen më efektive.

Stafi i përfshirë në procesin e raportimit dhe reagimit do të vihet në dijeni për përgjegjësinë e tij për të ruajtur konfidencialitetin. Stafi që shkel konfidencialitetin mund t'i nënshtrohet masave disiplinore.

8.5 Raportet rreth organizatave ose partnerëve të tjerë

Raportet në lidhje me organizatat e tjera do të referohen tek organizata përkatëse nëpërmjet kanalit të duhur mbrojtës, kur është e sigurt për ta bërë këtë. Aty ku është e nevojshme, do të përfshihen organet ose autoritetet koordinuese.

As SOS Fshatrat e Fëmijëve International dhe as shoqatat anëtare të saj nuk do të hetojnë raste që lidhen me organizata apo partnerë të tjerë, por kanë detyrimin për të raportuar. Pasi një pretendim të bëhet i njohur për SOS Fshatrat e Fëmijëve International ose ndonjë nga shoqatat anëtare të saj, masat e duhura do të vendosen për të garantuar sigurinë e të gjithë të përfshirëve.

Kur pretendimet vërtetohen si të vërteta, do të kryhet një rishikim i brendshëm i përputhshmërisë me këtë dhe rregullore të tjera gjatë angazhimit me partnerin përkatës.

9 Reagimi

Shoqata përkatëse anëtare ose SOS Fshatrat e Fëmijëve International do t'i përgjigjet në mënyrë profesionale, objektive dhe në kohë të gjitha shqetësimeve apo pretendimeve për ngacmim, shfrytëzim apo abuzim seksual. Shqetësimet ose pretendimet do të merren seriozisht, do të hetohen dhe do të ndërmerren veprimet për to sipas rastit.

9.1 Vlerësimi Fillestar

Ekipi i Integritetit dhe Masave Mbrojtëse vlerëson pretendimin brenda maksimumit prej 5 ditë pune pas marrjes së raportit; nëse është e nevojshme, informacioni sqarohet më tej me raportuesin. Ekipi vendos për hapat e mëtejshëm:

- Në rast të një veprë të dyshuar kriminale, **autoritetet** përkatëse njoftohen sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që të ndërmarrin veprime dhe të kryejnë një hetim të jashtëm. Përrjashtimi i vetëm (që duhet konfirmuar nga shoqata përkatëse ose drejtori i zyrës të GSC) është nëse të drejtat e të mbijetuarve, raportuesve, dëshmitarëve ose autorëve të dyshuar do të vireshin në rrezik duke vepruar kështu.
- Në momentin që nevojiten prova nga palët e treta për të mbështetur ose hedhur poshtë pretendimet, kryhet një **hetim**. Në bazë të termave të qarta të referencës, caktohet një hetues.
- Nëse identifikohet një **konflikt interesi**, përgjegjësia për trajtimin e raportit raportohet (**përshkallëzohet**). Një konflikt interesi ekziston veçanërisht nëse raporti përfshin një shqetësim në lidhje me menaxhmentin e lartë ose anëtarët e bordit të një shoqate anëtare, ose menaxhmentin e një zyre të GSC:
 - Raportet në programet kombëtare mund të përshkallëzohen te zyra kombëtare.
 - Raportet në shoqatat anëtare mund të përshkallëzohen te IOR dhe/ose bordi i shoqatës.
 - Raportet e IOR përshkallëzohen te IO.
 - Raportet që kanë të bëjnë me anëtarët e organeve drejtuese të SOS Fshatrat e Fëmijëve International (p.sh. Ekipi Menaxhues, Senati Ndërkombëtar, etj.) i përshkallëzohen organit drejtues përkatës, i cili merr veprimet përcjellëse për raportin sipas hapave të përcaktuar në këtë rregullore. Ky organ do të mbikëqyrë vlerësimin dhe hetimin e rastit, duke përdorur burimet e jashtme kur është e nevojshme, dhe do të vendosë për pasojat dhe masat disiplinore.
- Nëse informacioni i dhënë tregon se opsionet e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve (si ndërmjetësimi, trajnimi, sensibilizimi, etj.) janë më të përshtatshme se sa një hetim, Ekipi i Integritetit dhe Masave Mbrojtëse mund t'ua ofrojë këtë palëve të përfshira. Çdo palë ka të drejtë të ndalojë proceset e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve në çdo moment dhe t'ia kthejë çështjen Ekipit të Integritetit dhe Masave Mbrojtëse.
- Në rrethana të jashtëzakonshme, nëse nuk ka informacion të mjaftueshëm për të nisur një hetim ose për të përshkallëzuar raportin, ekipi mund të vendosë të mbyllë çështjen. Nëse dalin informacione shtesë të rëndësishme, çështja duhet të rihapet.

Palët përkatëse njoftohen për hapat e ardhshëm.

9.2 Hetimet

Pas vlerësimit fillestar, nëse gjykohet e nevojshme, mund të iniciohet një hetim nga Ekipi përkatës i Integritetit dhe Masave Mbrojtëse në SOS Fshatrat e Fëmijëve International ose shoqata anëtare. Shrirja e një hetimi ndryshon në varësi të pretendimit: ai mund të drejtohet nga një hetues ose nga një ekip hetimor, i cili mund të jetë staf i trajnuar i SOS-it ose hetuesë të jashtëm. SOS Fshatrat e Fëmijëve International dhe shoqata anëtare e saj do të kryejnë hetime të paanshme sipas parimeve të mëposhtme:

- **Siguria:** Siguria dhe mirëqenia e të mbijetuarit të supozuar, raportuesit dhe dëshmitarëve janë konsideratat kryesore. Të mbijetuarit duhet të trajtohen në mënyrë të ndjeshme.
- **Konfidencialiteti:** Raportuesi, i mbijetuari i supozuar, dëshmitarët si dhe autori i dyshuar kanë të drejtën e konfidencialitetit, me përjashtim të rrethanave specifike (p.sh. referimi tek autoritetet). Informacioni është i disponueshëm vetëm për një numër të kufizuar personash të autorizuar për qëllimin e kryerjes së hetimit (d.m.th., zbulimi i informacionit vetëm në bazë të *nevojës për ta ditur*).
- **Ligjshmëria:** Hetimet duhet të nisen, kryhen dhe raportohen në përputhje me të gjitha rregullat, rregulloret dhe udhëzimet në fuqi, duke përfshirë respektimin e duhur për të drejtat dhe privatësinë e personave të përfshirë. Duhet t'i kushtohet vëmendje ligjit vendor pasi lidhet

Parandalimi dhe Mbrojtja nga Ngacmimi, Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual

me mbledhjen e provave jashtë ambienteve të organizatës dhe gjatë intervistimit të dëshmitarëve jo-punonjës. Nëse gjatë një hetimi lindin indikacione për një vepër të mundshme penale, autoritetet përkatëse informohen (përveç rastit kur të drejtat e palëve të përfshira vihen në rrezik).

- **Përpikmëria:** Një hetim kryhet në mënyrë dilijente, të plotë dhe të fokusuar për të siguruar që të merren provat përkatëse për të vërtetuar faktet në lidhje me pretendimin (et).
- **Profesionalizmi:** Stafi që kryen hetime duhet të ketë aftësi, trajnim dhe njohuri të përshtatshme. Metodologjia dhe teknikat e përdorura në hetim duhet të jenë të përshtatshme për objektivat dhe rrethanat e secilit hetim.
- **Paanshmëria:** Hetimet duhet të kryhen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. Provat duhet të mbliidhen dhe raportohen në mënyrë të paanshme dhe të pavarur për të përcaktuar vlefshmërinë e një pretendimi. Hetuesit duhet të jenë të lirë, si në fakt ashtu edhe në dukje, nga çdo ndikim që mund të dëmtojë gjykimin e tyre. Hetuesit duhet të informojnë menaxherin e tyre për çdo konflikt të mundshëm interesi ose ndikim në mënyrë që të ndërmarrin veprime për të zgjidhur këto çështje përpara fillimit të hetimit.
- **Planifikimi, koha, dokumentacioni:** Hetimet duhet të porositen, planifikohen, dokumentohen dhe përfundojnë qartë sa më shpejt të jetë e mundur. Raportet dhe konkluzionet e hetimit duhet të mbështeten me të dhëna dhe dokumentacion adekuat, të saktë. Dokumentacioni mbahet në mënyrë konfidenciale dhe menaxhohet në përputhje me ligjin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë.

Hetuesit marrin përsipër një përgjegjësi të rëndësishme dhe do të mbështeten nga organizata për të përmbushur detyrën e tyre. Çdo presion apo veprim hakmarrës ndaj hetuesve do të ndiqet me pasoja disiplinore.

Raporti i hetimit përfshin rekomandime specifike vijuese dhe i dorëzohet Ekipit të Integritetit dhe Masave Mbrojtëse.

I mbijetuari dhe autori i dyshuar marrin një kopje të gjetjeve përmbledhëse.

9.3 Vendimmarrja dhe pasojat

Bazuar në rezultatet e hetimit, Ekipi i Integritetit dhe Masave Mbrojtëse do t'i rekomandojë vendimmarrësit veprimet e duhura.

Përpara çdo vendimmarrjeje, të mbijetuarit dhe autorët e dyshuar kanë të drejtë t'i përgjigjen gjetjeve të hetimit. Kjo mund të jetë me shkrim ose përmes një seance dëgjimore formale.

Vendimi përfundimtar për pasojat dhe masat disiplinore janë përgjegjësi e personave të mëposhtëm:

- në shoqatat anëtare:
 - drejtori kombëtar/menaxhues
 - bordi i shoqatës nëse incidenti përfshin drejtorin kombëtar/menaxhues
- në zyrat ndërkombëtare rajonale:
 - rajoni i drejtorit ndërkombëtar
 - Ekipi Menaxhues nëse incidenti përfshin rajonin e drejtorit ndërkombëtar
- në Zyrën Ndërkombëtare: Ekipi Menaxhues
- nëse incidenti përfshin anëtarë të organeve ligjore të SOS Fshatrat e Fëmijëve International (p.sh. Ekipi Menaxhues, Senati Ndërkombëtar, etj.): organi drejtues përkatës

Vendimi për pasojat merret në brenda maksimum 20 ditë pune pas marrjes së raportit të hetimit.

Në përputhje me politikën e zero tolerancës, të gjitha pretendimet që rezultojnë të vërteta kërkojnë masa të qarta disiplinore. Ndërmerren masa proporcionale në varësi të seriozitetit të veprës. Në rrethana të caktuara, dhe vetëm me pëlqimin e plotë të të mbijetuarit (ës), mund të merren parasysht qasje të tilla si drejtësia restauruese ose ndërmjetësimi.

Veprimet e mëtejshme përcjellëse mund të përfshijnë mbështetjen psiko-sociale dhe/ose masa mbrojtëse për të mbijetuarin, raportuesin ose dëshmitarët. Masat mbështetëse gjatë gjithë fazës së reagimit bazohen në një hartëzim lokal të shërbimeve psikologjike, mjekësore dhe ligjore të disponueshme.

Raportuesit, të mbijetuarit dhe autorët informohen për vendimet e marra dhe arsyetimin prapa këtyre vendimeve, për aq sa është e mundur sipas ligjit kombëtar në fuqi. Do të merren masat e duhura për të garantuar sigurinë dhe mbështetjen e vazhdueshme të të gjithë të përfshirëve.

Të mbijetuarit dhe autorët e dyshuar mund të kërkojnë një rishikim të vendimit brenda një afati kohor të përcaktuar, siç përshkruhet në udhëzuesit përkatës të përdoruesit.

9.4 Mbyllja dhe mësimet e nxjerra

Mbyllja e rastit u komunikohet me shkrim të gjitha palëve të përfshira.

Dokumentacioni përkatës i rastit arkivohet për një afat të kufizuar në një dosje konfidenciale. Të gjitha dokumentet e tjera të rastit do të shkatërrohen në mënyrë të sigurt. Shkeljet e konfirmuara dhe masat disiplinore përkatëse përfshihen në dosjen konfidenciale të personelit.

Ekipi i integritetit dhe masave mbrojtëse dhe grupi hetimor mbajnë një konferencë përfundimtare të rastit për të diskutuar mësimet përkatëse të nxjerra. Kërkohen komentet kthyes nga i mbijetuari dhe raportuesi. Mësimet e nxjerra të anonimizuara ndahen sipas rastit me organet përkatëse për të lehtësuar përmirësimin.

9.5 Raportimi Organizativ

SOS Fshatrat e Fëmijëve International-it dhe çdo shoqate anëtare i kërkohet të përgatisë raporte të rregullta të integritetit duke përfshirë statistikat bazë të PSHEA dhe veprimet parandaluese të zbatuara në periudhën raportuese si më poshtë:

9.5.1 Shoqatat anëtare

- Drejtori kombëtar/menaxhues paraqet një raport integriteti pranë bordit të shoqatës dy herë në vit. Bordi ka përgjegjësinë e mbikëqyrjes për të siguruar që të jetë vendosur një qasje e shëndoshë e PSHEA-së.
- Drejtori kombëtar/menaxhues siguron një raport vjetor të integritetit për SOS Fshatrat e Fëmijëve International.

9.5.2 SOS Fshatrat e Fëmijëve International

- Drejtori kombëtar/menaxhues i operacioneve të drejtuara nga GSC siguron një raport vjetor të integritetit për SOS Fshatrat e Fëmijëve International.
- Çdo drejtor ndërkombëtar i rajonit i siguron Ekipit Menaxhues një raport vjetor të integritetit duke përfshirë statusin e PSHEA në IOR.
- Ekipi i Zyrës Ndërkombëtare të Integritetit dhe Masave Mbrojtëse i siguron Ekipit Menaxhues një raport vjetor të integritetit duke përfshirë statusin e PSHEA në Zyrën Ndërkombëtare.
- Ekipi Menaxhues i SOS Fshatrat e Fëmijëve International i siguron një raport vjetor të integritetit Senatit Ndërkombëtar. Ky raport përpilon statusin e PSHEA në federatë dhe në SOS Fshatrat e Fëmijëve International. Senati Ndërkombëtar ka përgjegjësinë e mbikëqyrjes për të siguruar që të jetë vendosur një qasje e shëndoshë ndaj PSHEA.
- SOS Fshatrat e Fëmijëve International publikon nga jashtë një raport vjetor që përmbledh statusin e PSHEA brenda federatës dhe mënyrën se si kanë funksionuar mekanizmat tanë të raportimit dhe reagimit gjatë vitit paraprak.

Shtojca

A. Termat dhe shkurtesat kryesore të përdorura në dokument

Fëmijë	Fëmijë nënkupton çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç (UNCRC, Neni 1).
Konflikti i interesit	Një situatë që ka potencialin të dëmtojë paanshmërinë e një personi për shkak të mundësisë së një përplasjeje midis detyrave dhe kërkesave të pozicionit dhe interesave të veta private.
Ekipi i integritetit dhe masave mbrojtëse	Ekipi ndërfunksional i krijuar në SOS Fshatrat e Fëmijëve International dhe në çdo shoqatë anëtare për të mbështetur zbatimin e masave parandaluese dhe për të menaxhuar procesin e raportimit dhe reagimit (shih 3.5).
Shoqata anëtare	Një organizatë anëtare e SOS Fshatrat e Fëmijëve International, që zbaton dhe/ose financon programet e SOS Fshatrat e Fëmijëve.
Partnerët	Në këtë dokument, Partnerët i referohen: Çdo organizatë me të cilën punojnë entitetet e SOS Fshatit të Fëmijëve, ku ajo organizatë ka qasje e stafi, vullnetarët, pjesëmarrësit e programit dhe/ose të dhënat nga ato grupe. Kjo përfshin: donatorët, partnerët e ofrimit të programit, partnerët për mbledhjen e fondeve, kontraktorët e mirëmbajtjes, organizatat me bazë në komunitet, departamentet qeveritare, etj..
PSHEA	Parandalimi dhe mbrojtja nga ngacmimi, shfrytëzimi dhe abuzimi seksual
Raportues	Personi që raporton një ankesë, shqetësim, pretendim ose dyshim të SHEA (i referuar si <i>raport</i> në këtë dokument). Në disa situata, një raportues mund të quhet edhe si <i>sinjalizues</i> .
SHEA	Ngacmimi, shfrytëzimi dhe abuzimi seksual
SOS Fshatrat e Fëmijëve International	Shoqata austriake e regjistruar në regjistrin austriak të shoqatave me seli në Innsbruck, Austri dhe e përfaqësuar ligjërisht nga Kryeshefi Ekzekutiv, Kryeshefi Operativ dhe Zytari Kryesor Financiar. Sekretariati i Përgjithshëm i saj menaxhon operacionet e saj të përditshme, duke përfshirë operacionet e drejtuara nga GSC, dhe përbëhet nga Zyra Ndërkombëtare në Austri dhe Zyrat Ndërkombëtare Rajonale në Evropë, Afrikë, Azi dhe Amerikën Latine.
I mbijetuar	Një person ndaj të cilit është kryer ngacmimi, shfrytëzimi dhe abuzimi seksual (SHEA) ose ndaj të cilit ka pasur një tentim për të kryer SHEA.
UNCRC	Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës
Të rinj	Personat ndërmjet moshës 10 dhe 24 vjeç (siç përcaktohet nga OBSH dhe UNICEF).

B. Lista e kanaleve ndërkombëtare të raportimit

Nëse dëshironi të raportoni një shqetësim SHEA, ju lutemi merrni parasysh fillimisht **kanalet e raportimit të disponueshme në shoqatën ose zyrën tuaj**.

Kanalet e mëposhtme janë të disponueshme për të raportuar të SHEA në nivel federate:

- Nëse shqetësimi juaj ka të bëjë me **sigurinë e fëmijëve**, mund të raportoni përmes kanalit të sinjalizimit në internet: <https://www.sos-childrensvillages.org/ëhat-ëe-do/child-safeguarding-sos/report-a-child-safety-concern>
- Ju mund të raportoni shqetësime të tjera të SHEA tek PSHEA@sos-kd.org.